


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr. 5 , datë 21.02.2024



PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “DENAS POWER” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Denas Power”, sipas Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” Nr. 62 Rep., Nr. 10 Kol., datë 03.04.2013 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoriteti Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Rej” sh.p.k, “B.A.D” sh.p.k, “Atlas” sh.p.k, (Koncesionari) për ndërtimin e hidrocentralit “Denas” Kontratën Shtesë Koncesionit Nr. 263 Rep., Nr. 85 Kol., datë 05.05.2015 “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit Denas”. , me vendndodhje në rrjedhën e poshtme të lumit të Cemicës dhe Becit degë të lumit Devoll Qarku Korçë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Denas

Vendndodhja e veprës së marrjes i lumi i Cemicës

- X= 543866.5; Y= 4498928; Z=832 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 9 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 3,15 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0,61 m³/s
- Prurja ekologjike: 0,61 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2 lumi i Becit

- X= 538301; Y= 4498982; Z=842 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 3,5 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 1,05 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0,2 m³/s
- Prurja ekologjike: 0,3 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 541364.2; Y= 4500956; Z=652 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 12,5 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 52.674.144 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 14.500 kwh

Koordinatat e pikës së shkarkimit, ku kanali i largimit të godinës së HEC-it, takon trupin ujqor pritës:

- X 541366.8 Y 4500966.7 Z +652 m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I K.B.U SEMAN

RAJMONDA BALILAJ

